

VENDIM
Nr.143, datë 8.3.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS, PËR HEQJEN E NDËRSJELLË TË VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës, për heqjen e ndërsjellë të vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS, MBI HEQJEN RECIPROKE TË VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës (më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”),
të vendosura për zhvillimin e marrëdhënieve të miqësisë dhe bashkëpunimit,
me dëshirën për të lehtësuar udhëtimet zyrtare të mbajtësve të pasaportave diplomatike apo të shërbimit ndërmjet dy shteteve,
ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e Mbretërisë së Spanjës, mbajtës të pasaportave spanjolle në fuqi, diplomatike apo të shërbimit, mund të hyjnë pa viza në territorin e Republikës së Shqipërisë për një kohë qëndrimi deri në 90 ditë (tre muaj) gjatë një periudhe prej 180 ditësh (gjashtë muaj), me kusht që gjatë qëndrimit të tyre të mos angazhohen në veprimtari fitimprurëse, përveç atyre që kryhen për qëllime të akreditimit.

Neni 2

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mbajtës të pasaportave shqiptare në fuqi, diplomatike apo të shërbimit, mund të hyjnë në territorin e Spanjës pa viza për një kohë qëndrimi deri në 90 ditë (tre muaj) gjatë një periudhe prej 180 ditësh (gjashtë muaj), me kusht që gjatë qëndrimit të tyre të mos angazhohen në veprimtari fitimprurëse, përveç atyre që kryhen për qëllime të akreditimit.

Kur ata hyjnë në territorin e Mbretërisë së Spanjës, pas kalimit transit në territorin e njërit apo më shumë vendeve për të cilët aplikohen plotësisht dispozitat në lidhje me eliminimin e kontrollit të brendshëm të kufijve dhe kufizimeve të lëvizjeve të personave, siç është parashikuar në pjesën e dytë të Konventës për zbatimin e Marrëveshjes së Schengen-it, të datës 19 qershor 1990, tre muaj do të llogariten duke filluar nga data e kalimit të kufirit të jashtëm që përcakton zonën e lëvizjes së lirë të krijuar nga shtetet e sipërpërmendura.

Neni 3

Dispozitat e mësipërme nuk i përjashtojnë përfituesit e tyre nga detyrimi për të respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me Mbretërinë e Spanjës, respektivisht pa

paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e garantuara nga konventat ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme për Palët Kontraktuese.

Neni 4

Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Spanjës do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave respektive diplomatike dhe të shërbimit në fuqi nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Ministritë e sipërpërmendura do të informojnë menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme njëra-tjetrën për çdo ndryshim të bërë në legjislacionet e tyre për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, si edhe për ndonjë ndryshim në formatin e tyre, gjë për të cilën duhet t'i dorëzojnë palës tjetër ekzemplarë të rinj.

Neni 5

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët ndërmjet Palëve Kontraktuese nëpërmjet shkëmbimit të notave. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e vendosur në paragrafin 2 të nenit 8.

Neni 6

Secila nga Palët Kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht apo pjesërisht, për një kohë të përcaktuar, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit publik apo shëndetit publik. Marrja apo anulimi i një mase të tillë do të komunikohet sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet rrugëve diplomatike. Një pezullim i tillë do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë, pasi Pala tjetër Kontraktuese të ketë marrë njoftimin.

Neni 7

Secila nga Palët Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes rrugëve diplomatike. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga Pala tjetër.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje përfundohet për një kohë të pacaktuar.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht, pasi të kenë kaluar tridhjetë ditë nga data e nënshkrimit të saj dhe do të hyjë në fuqi ditën e fundit të muajit pasardhës të komunikimit të fundit në rrugë diplomatike midis Palëve Kontraktuese, për njoftimin mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore të brendshme për hyrjen në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve Kontraktuese nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 6 shkurt 2006, në 2 kopje origjinale, në gjuhët shqip dhe spanjisht, duke qenë të dy tekstet autentike të barabarta.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Ministri i Punëve të Jashtme Besnik Mustafaj	Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës Ministri i Punëve të Jashtme dhe i Bashkëpunimit Miguel Angel Moratinos Cuyaube
--	--